**KONTRATË E SHITJES SË PJESËVE TË KAPITALIT**
**("Kontrata")**

Sot, më datë 11 /03/2021, palët e mëposhtme nënshkruajnë këtë kontratë:

**Z. Can HATIPOGLU**, shtetas Turk, lindur më 10.01.1992 në Damask, Siri, dhe banues në Stamboll, Turqi, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës Turke me numër U15007539, zotërues i një kuote me vlerë 30 Lek e barasvlefshme me 30% të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë DUATENDA sh.p.k (në vijim **"shitësit"**);

dhe

**Z. Eyup Sinan TEKIN**, shtetas Shqiptar, lindur më 21.07.1984 në Bakirkoy, Turqi, banuese në Tiranë, mbajtëse e pasaportës letërnjoftimit me numër personal I40721205G, (në vijim **"blerësi"**);

(Në vijim Shitësit dhe Blerësi do të përcaktohen bashkërisht si **"Palët"** dhe veçmas si **"Pala").**

**Kushtet paraprake:**

a) Shitësi zotëron 1 kuotë të kapitalit të regjistruar të shoqërisë **DUATENDA sh.p.k**, me seli në Rruga Ura e Gjoles, Bubq, Fushë-Krujë, Shqipëri, me NUIS M11502021Q (referuar më poshtë si **"Shoqëria"**).

b) Shitësi dëshiron ti shesi Blerësit, i cili pranon, kuotën e zotëruar prej tij që përfaqëson 30% (tridhjetë) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.

**Neni 1**
**Shitja e kutave**

1.1 Nëpërmjet kësaj kontrate, Shitësi i shet dhe i transferon Blerësit, i cili pranon, kuotat e zotëruar në shoqërinë **DUATENDA sh.p.k**, me seli në Rruga Ura e Gjoles, Bubq, Fushë-Krujë, Shqipëri, me NUIS M11502021Q.

1.2 Titulli i pronësisë mbi kuotën do të transferohet nga Shitësi tek Blerësi me nënshkrimin e kësaj kontrate.

**Neni 2**
**Deklarime dhe Garanci të Shitësve**

2

2.1 Shitësi deklaron dhe garanton se është i vetmi pronar dhe titullar i kuotës dhe të drejtave që rrjedhin prej saj dhe ka të drejtën e plotë për të transferuar pronësinë e kuotës tek Blerësi.

**Neni 3**
**Çmimi i shitjes**

3

3.1 Vlera e shitjes së kuotës së përmendura në pikën 1.1 më sipër është në vlerën reale gjithsej 30 Lekë (tridhjetë lekë). Kjo vlerë është paguar plotësisht nga Blerësi tek Shitësi dhe palët nuk kanë asnjë pretendim lidhur me çmimin dhe mënyrën e pagesës.

**Neni 4**
**Ekzekutimi dhe transferimi**

4

4.1 Me realizimin e kësaj Kontrate, pjesa e kapitalit që do të zotërohet nga ortaku Z. Eyup Sinan TEKIN do të jetë 80%.

4.2 Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, vlera e kapitalit të zotëruar nga Z. Eyup Sinan TEKIN do të jetë 80 LEK (tetëdhjetë).

**Neni 5**
**Shpenzimet dhe regjistrimi në QKB**

5.1 Shpenzimet për lidhjen e Kontratës do të jenë në ngarkim të palëve në pjesë të barabarta.

5.2 Shitësi autorizon Blerësin për të kryer regjistrimin e Kontratës dhe të transferimit të pronësisë së Kuotës pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit **("QKB")**.

**Neni 6**
**Zgjidhja e mosmarrveshjeve**

6

6.1 Palët angazhohen të zgjidhin me mirëkuptim çdo mosmarrveshje që lidhet me interpretimin dhe ekzekutimin e kësaj Kontrate.

6.2 Në rast se një zgjidhje e tillë nuk është e mundur, mosmarrveshja do të zgjidhet ekskluzivisht nga Gjykata e rrethit Gjyqësor Tiranë.

*****

**SHITËSI**
**Z. CAN HATIPOGLU**

Can Hatipoglu

**BLERËSI**
**Z. EYUP SINAN TEKIN**

Eyup Sinan TEKİN